



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:058489

Datë: 27.11.2020

Numri i dokumentit: 01302478

C.nr.996/ 18

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mevlide Shabani, duke vendosur në çështjen juridike kontestuese të paditësit S.M. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson “Avokatura Istrefi” nga Prishtina rr.”BillKllinton” Hr.69 kati 1 nr.1 ,avokatët Zaim Istrefi, Arbër Istrefi dhe Jeton Idrizi të gjithë nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson avokati Adnan Pacolli nga Prishtina, me bazë juridike kompensim i dëmit material dhe jo material, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë12.11.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.M. nga Gjilani, dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e sigurimeve “Siguria, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **19,777.80€** edhe atë:

a. Dëmin jo material:

- në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara shumën prej 4.000 €
- në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000 €
- në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,000€
- në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësorë, për 12.7%, shumën prej 8,500.00 €

b.Dëmin material:

- në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 196 €
- në emër të ushqimit të përforcuar shujënperj 117,60 € dhe
- në emër të dëmtimit material-fitimit të humbur për periudhën kohore nga data 01.01.2014 e deri më dt.01.06.2014 shumën prej 2,964.00 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 12.11.2020 e deri në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e aprovuara në lartësi prej **4,859.00€** e kërkuar më shumë se shuma e gjykuar.

III. DETYROHET e paditura Kompania e sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e domosdoshme gjyqësore në shumë prej 1,952,65€, të

gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m

Më datë 16.11.2018, në këtë gjykatë, paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Prishtinë, në të cilën padi ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e tij dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të dëmshpërblimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuara si pasojë e aksidentit të trafikut të datë 01.04.2014 t’ia paguaj shumën prej 36,500.00€. Ndërsa në shqyrtimin gjyqësorë të datës 12.11.2020, ka bërë zvogëlimin e kërkesëpadiisë ashtu që në vend të shumës së lartcekur tani kërkon shumën prej 24,637,60€, për 80% të përgjegjësisë së të paditurës dhe ate: për dhimbje fizike, 5,600€, për frikë 4,000€, për shëmtim trupor 1,600€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shumën prej 10.160€, për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj 196 euro, për ushqim të përforcuar 117,60€ dhe në emër të pagave neto për periudhën nga data 01.01.2014 e deri më dt.01.06.2014 shumën e të hollave në lartësi prej 2,964,00€.

Ka shtuar se me datën 01.01.2014 rreth orës 20:30 min në rrugën “Haqif Tetova” në Gjilan është shkaktuar aksident trafiku, në të cilën lëndime të rënda trupore me pasojë për jetë ka pësuar paditësi S.M. Deri te aksidenti ka ardhur kur ngasësi i automjetit të udhëtarëve BMW X5 me targa ...- të cilën e drejtonte A.S. duke qarkulluar në rrugën njëkahëshe në Gjilan në drejtim të ambulancës “Dardania I”, kur arrinë në afërsi të autolarjes “Rizi” nga pakujdesia duke lëvizur me shpejtësi të madhe përtej normave të lejuara e duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur këmbësorëve me pjesën e përparme e godet këmbësorin S.M. i cili në ato moment ishte duke e kaluar rrugën. Si pasojë e kësaj goditje lëndime të rënda trupore me pasojë për jetë pëson këmbësori tani paditësi S.M. nga Gjilani. Automjeti i udhëtarëve me të cilin u shkaktuar aksidenti BMW X5 me targa ... ishte i siguruar te e paditura.

I autorizuari i paditësit si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë sa i përket bazës juridike të kërkesëpadiisë në kuptim të shkaktimit të aksidentit nga i siguruari i të paditurëve duke i propozuar gjykatës që të caktohet një ekspert i komunikacionit në mënyrë që i njëjti të jap mendimin dhe konstatimin e tij për rrethanat që është shkaktuar aksidenti dhe të përcaktoj përgjegjësinë e pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit, po ashtu i ka propozuar gjykatës që të caktojë një ekspert nga lëmia e ortopedis-trumatolog dhe psikiatër të cilët do të japin mendimin dhe konstatimin e tyre për natyrën dhe shkallën e lëndimeve që i kanë shkaktuar paditësit. Po ashtu meqenëse paditësi ka pasur zvogëlim të aftësisë punuese i ka propozuar gjykatës që të caktohet një ekspert nga mjekësia e punës në mënyrë që i njëjti të jap mendimin dhe konstatimin e tij se sa është zvogëluar aftësia e punës. Pas marrjes së ekspertizave dhe ekspertizën e ekspertit aktuar dhe provat e administruara është argumentua baza juridike e kërkesëpadiisë për të cilën e paditura mban përgjegjësi prej 80% e që nuk ishte kontestuese në mes palëve, andaj bazuar në këtë i propozojmë gjykatës që kërkesëpadiinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar sipas parashtrësës dhe precizimit në seancën gjyqësore pasi që shumat e kërkuara paraqesin një satisfaksion të merituar material për pasojat që paditësi ende i vuan, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%. Gjithashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet gjyqësore duke i specifikuar.

E paditura përmes të autorizuarit të saj si në përgjigje në padi ashtu edhe në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton pjesërisht bazën juridike të kërkesëpadiisë dhe lartësinë e saj duke shtuar se në bazë të provave të cilat gjenden

në shkresat e lëndës, rezulton se paditësi në aksidentin e shkaktuar më datën 01.01.2014, ka kaluar rrugën jashtë vendkalimit të kalimit të këmbësorëve ma çka ka kontribuar në skaktimin e aksidentit, andaj mbi këtë bazë për hirë të ekonomizimit të procedurës e paditura pranon përgjegjësin 80% të përgjegjësisë dhe mbi këtë bazë janë të gatshëm që sipas nxjerrjes së ekspertizave të arrijnë pajtim gjyqësorë duke i ofruar paditësit për të gjitha format e dëmit kompenzues shumë prej 7500€.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridiko civile në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Raporti i aksidentit me numër 2014-CR-001, i datës 01.01.20148, së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes; Raporti i zyrtari policor i dt.01.01.2014 i lëshuar nga policia e Kosovës-Drejtoria Rajonale e trafikut në Gjilan; Fletëlëshimi i lëshuar nga Spitali Rajonal i Gjilanit-Reperti i Kirurgjisë i dt.08.01.2014; Ekspertiza e komunikacionit e datës 15.06.2019 e ekspertit Skender Shala; Mendimi i ekspertëve mjekësor nga dr.SamiDelijaj, ekspert i ortopedisë dhe traumatologjisë, Dr.Nazmije Musliu eksperti psikiatre dhe dr.AliHajra ekspert i mjekësisë së punës e dt.11.11.2019, ekspertiza nga lëmia e sigurimeve, aktuaristike dhe financave e dt.18.05.2020 e punuar nga eksperti Aziz Berisha së bashku me provat shtesë, pasqyra e llogarisë nga trusti për paditësin S.M. për periudhën e raportimit prej 01.01.2013-31.12.2015.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform nga neni 8 i LPK-ës, dhe bindjes së lirë të gjykatës, e cila lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike e që duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 01.01.2014 rreth orës 20:30 min në rrugën “Haqif Tetova” në Gjilan, në të cilin aksident trafiku lëndime të rënda trupore me pasoj për jetë ka pësuar paditësi S.M.. Deri te aksidenti ka ardhur kur ngasësi i automjetit të udhëtarëve BMW X5 me targa ...- të cilin e drejtonte A.S. i cili qarkullonte në rrugon njëkahëshe në Gjilan në drejtim të ambulancës Dardania I, kur arrinë në afërsi të autolarjes “Rizi” nga pakujdesia duke lëvizur me shpejtësi të madhe përtej normave të lejuara e duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur këmbësorëve me pjesën e përparme e godet këmbësorin S.M. i cili në ato moment ishte duke e kaluar rrugën. Si pasojë e kësaj goditje lëndime të rënda trupore me pasoj për jetë pëson këmbësori - tani paditësi S.M. nga Gjilani.

Në mes të palëve ndërgjyqjësë nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, meqë i autorizuari i palës së paditur në shqyrtimin e fundit gjyqësor të datës 12.11.2020 pas pranimin të përgjegjësisë prej 80% i ka ofruar ofertë paditëses për arritjen e marrëveshjes edhe atë në shumë prej 7500€ .

Nga ekspertiza ekomunikacionit e përpiluar me datën 15.06.2018 nga eksperti i aksidentëve të komunikacionit Ing i dip.Skender Shala, gjykata vërtetoi faktin se aksidenti ka ndodhur me fajin e të siguruarit te e paditura i cili ka drejtuar automjetin pa patent shofer dhe se drejtuesi i automjetit kishte mundësinë, kohën e nevojshme dhe arsyen e mjaftueshme për të frenuar vrullshëm, por në rrugë nuk janë paraqitur gjurmë të frenimit, të cilat do të mbetnin gjatë frenimit të vrullshëm dhe se reagimi i drejtuesit ka qenë me vonesë dhe jo i duhur e në këtë ka pasur disa faktor si dukshmëria e zvogëluar nga errësira dhe përgatitja jo e mjaftueshme e drejtuesit për të drejtuar automjetin.

Në këtë rast, kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë, ashtu që për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata nga ekspertiza mjekësore të punuara nga Dr.SamiDelijaj eksperti i Ortopedisë dhe traumatologjisë, Dr.sci Nazmie Musliu eksperte psikiatre dhe dr.AliHajra ekspert i mjeksësi së punës, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit

të drejtpërdrejte të paditësit, e kanë dhënë mendimin profesional përmes ekspertizës së punuar me shkrim të datës 11.11.2019, ku sipas tyre paditësja ka përjetuar dhembje të intenzitetitposaçërisht të rëndë 1 orë, dhimbje fizike të intesitetit të rëndë që ka zgjatur 48 orë, dhimbje fizike të intesitetit të mesëm që kanë zgjatur 35 ditë dhe dhimbje fizike të intesitetit më të ultë që janë prezent sot e asaj dite kryesisht manifestohen në regjionin e kokës, qafës, krahut të majtë dhe gjoksit sipas të dhënave anamnesitke të paditësit, (të cilësuar si lëndime të rënda trupore), me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjeve fizike e aprovoi kërkesën e paditësit në shumë prej 4000 €, dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit.

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 3000 €, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertes mjekësore të psikiatrisë, frikë primare ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intesitetit të lartë që ka zgjatur 3 ditë, frikë sekondare e intesitetit të mesëm që ka zgjatur për 1 muaj, frikë sekondare të intesitetit të ulët që ka zgjatur 12 muaj e shoqëruar me brengën e vazhdueshme për ecurinë e mjekimit, vështërsive të adaptimit dhe kushtet e trajtimit mjekësor, nervozës rënies së disponimit dhe vullnetit, rënies së koncentrimtshqetësimve gjatë gjumit, pasigurisë së përgjithshme me ulje të performancëpsikosociale dhe disekuilibri emocional si dhe pasigurisë gjatë pesëmarrjes në komunikacon dhe i njejt aktualisht ende ankohet për shqetësime të shoqëruar me ankthe, të rrahura të shpeshta të zemrës, kryesisht simptome neurovegjetative në formë të krizës.

Gjykata e detyroi të paditurën për kompensimin e dëmit jomaterial në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 12.70% në shumë prej 8500 € e cila është manifestuar aktualisht me kokëdhimbje, marramendje, kufizim të lëvizshmërisë së kokës dhe të qafës në pozita të detyruar dhe ndjeshmëri klinike gjatë ndryshimeve klimatike dhe pozitive të sforcuara fizike.

Në emër të shëmtimit trupor, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1000 € dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke marrë parasysh moshën e paditësit, poashtu edhe fakti se nga ekspertiza rezulton se te paditësi është prezent shëmtimi trupor i shkallës së ulët për shkak të cikatriksit në regjionin e kokës ana e majtë e cila është përpunuar në mënyrë kirurgjike dhe paraqet problem klinik që manifestohet me dhimbje kryesisht gjatë ndryshimit të temperaturave dhe prekjeve ose kontakteve direkte të asaj pjese si dhe problem psikoemocional për rrethin ku jeton, andaj shuma e kërkuar për këtë formë të dëmit paraqet satisfacion të merituar material duke pasur parasysh vuajtje dhe pasojat shpirtërore që paraqet ky shëmtim që është i përheshëm.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 196 €, si pasojë e lëndimeve të marra në aksident, në bazë të ekspertizës u vërtetua se ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër ka qenë i nevojshëm për 35 ditë dhe atë ndihmë në veshmbathje, mbajtje të higjenës personale ushqim, dhe kryerjen e disa aktiviteteve të përgjithshme jetësore i ndihmuar nga familjarët, duke konsideruar se është në proporcion me nevojat e paditësit.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 117,60€, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertëve u vërtetua se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për tri javë gjegjësisht 21 ditë dhe atë ushqim i pasur me albumina, minerale, proteina dhe vitamina më shumë se ushqimi i zakonshëm, andaj gjykata ka vlerësuar se shuma e lartëcekur është në proporcion me nevojën për ushqim të përforcuar të paditësit.

Në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore nga data 01.01.2014 e deri më datën 01.06.2014, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 2964 €, për shkak të pagesave të porealizuara, për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese me përgatitje shkollore të lartë dhe se nga kjo datë e deri më dt.01.06.2014 paaftësia e plotë dhe e përkohshme për punën që ka ushtruar paditësi ka qenë në shkallë prej 100%,.

Gjykata duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (LSDA) në të cilin citohet: *‘Kompenzimi i dëmit material dhe jo material bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve’*, andaj edhe ka zbatuar dispozitat e LMD-së.

Me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1 i LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jomaterial në të cilin citohet: *‘Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore, frikës..., gjykata do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. ‘ dhe në paragrafin 2 po të njëjtit ligj citohet: ‘Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.’*, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompenzimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara si dhe frikës së të dëmtuarit, ashtu që kompenzimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e kalimit të pasojave e që në këtë rast paditësi i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë që është e mundur duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompenzimin e dëmit.

Në bazë të nenit 179 në të cilin citohet: *‘Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë...’*, gjykata e aprovoi kërkesën e paditësit për kompenzimin e dëmit material.

Mbi bazën e kësaj gjendjeje faktike, gjykata vlerësoi se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësit me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësit t’ia kompensojë dëmin, në bazë të nenit 136 par.1 të LMD-së, në bazë të përgjegjësisë që parashihet: *‘Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.’* dhe nenit 156 par.1 po të njëjtit ligj në të cilin citohet: *‘Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.’*, andaj duke u bazuar në dispozitat e cekura më lart si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore që i janë shkaktuar paditësit dhe moshën e tij, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lart, gjykata e miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të diapozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real dhe objektiv dhe me bindjen se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Nga këto arsye, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit në shumë prej 4,859.00€ nga shumat e gjykuara si në diapozitivin I të këtij aktgjykimi e deri të shumat e kërkuara gjykata e shkallës së parë i refuzoi si të pa bazuara, ngase në bazë të provave të administruara, del se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk janë në proporcion me shkallën e dëmtimeve të shkaktuara.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatë ka vendosur në mbështetje të nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së.

Gjykata pati parasysh edhe provat e tjera të paraqitura në këtë proces të cilat edhe u administruan, mirëpo të njëjtat prova nuk u arsyetuan, pasi që nuk do të ndryshonin gjendjen faktike apo nuk do të kishte ndikim në marrjen ndryshe të vendimit, siç edhe është marrë në rastin konkret.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditësit t'i pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 1,952,65 Euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 245,44€, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 150€, për shpenzimet e ekspertizës mjekësore shumën prej 450€, për ekspertin financiar shumën prej 150€, për pjesëmarrje në tri seanca gjyqësore shumën prej 957,21 €, (3 seanca, për secilën seancë nga 319,07 Euro).

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.996/18, më datë 12.11.2020**

**Gjyqtarja,
Mevlide Shabani**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.